

PARTIA AGRARE AMBIENTALISTE (PAA)

HISTORIKU

Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë (PAA) është themeluar më 24 Janar 1991 nga një grup nismëtar i përbërë nga intelektualë të bujqësisë me në krye Mëno Gjoleka të cilët e rregjistruan atë me emrin Partia Agrare e Shqipërisë (PASH). Grupi Nismëtar e drejtoi PASH deri më 22 Janar 1992, kur u mbledh Konferenca e Parë Kombëtare e PASH, në të cilën u bënë për herë të parë zgjedhjet brenda Partisë. Konferenca zgjodhi Kryetar të saj Lufter Xhuvelin dhe e pozicionoi Partinë Agrare si një parti të qendrës në spektrin e politikës shqiptare. Duke ndjekur trendin e kohës, në programin e saj përveç problemeve të bujqësisë dhe zhvillimit rural, që përbëjnë boshtin e aktivitetit, Partia Agrare, ndërkohë ka bërë pjesë të rëndësishme të axhendës së saj edhe problemet e mbrojtjes së mjedisit dhe të burimeve natyrore. Në këtë kontekst në 21 Qershor 2003, Kongresi i IV i PASH miratoi ndryshimin e emrit në Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë (PAA). Ajo ka arritur të përfaqësohet me deputetë në katër legjislatura të Kuvendit të Shqipërisë dhe në të gjitha legjislaturat për pushtetin vendor. PAA ka arritur të ketë një numër të konsiderueshëm këshilltarësh në komuna dhe bashki si dhe drejtues të niveleve të ndryshme. Rezultatet më të mira elektorale i ka arritur në zgjedhjet e vitit 2005 kur u përfaqësua në Kuvendin e Shqipërisë me 4 deputetë dhe në zgjedhjet për pushtetin vendor të vitit 2007 kur arriti të marrë rreth 300 këshilltarë të komunave dhe bashkive të vendit, të fitojë 5 kryetarë komunash dhe shumë drejtues të këshillave të komunave dhe bashkive. Në zgjedhjet e vitit 2015 për pushtetin vendor, PAA fitoi këshilltarë në 16 bashki të vendit nga të cilat tre janë qendra qarqesh (Shkodër, Kukës, Gjirokastrë). Në 25 Mars 2016, Kryetari i PAA-së Lufter Xhuveli dha dorëheqjen nga kjo detyrë dhe Asambleja e Përgjithëshme e PAA me unanimitet të plotë zgjodhi Kryetar të Partisë Agrare Ambientaliste të Shqipërisë Agron Dukën, ish ministër i bujqësisë dhe deputet në Kuvendin e Shqipërisë. Ish kryetari Lufter Xhuveli u zgjodh Kryetar i Asamblesë së Përgjithëshme të PAA-së. Në zgjedhjet e vitit 2017, kryetari i PAA-së Agron Duka u zgjodh deputet nën siglën e Partisë Demokratike dhe gjatë vitit 2019 ai në koalicion me PD-në dhe LSI-në firmosi për djegien e mandatit të deputetit.

KRYETARI - AGRON DUKA

JETËSHKRIMI

Agron Duka u zgjodh kryetar i Partisë Agrare Ambientaliste në mars të vitit 2016. Ai ka lindur në Shijak dhe është diplomuar në Universitetin Bujqësor të Tiranës në degën Agronomi. Një nga pasionet e jetës së tij mbetet sporti dhe ka një karrierë 20 vjecare si volejbollist i Erzenit. Pas viteve 90 iu dha mundësia të merrej me biznes. Me të afërmit e tij krijoi shoqërinë Aiba. Nisma, përvoja, aftësitë administruese si dhe dëshira për të shërbyer e shtynë të pranonte postin e Prefektit të Durrësit. Vitet e fundit ka kryer detyrën e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit të Shqipërisë si dhe është zgjedhur deputet në Kuvendin e Shqipërisë. Gjatë vitit 2019, ai zgjodhi të ishte në koalicion me PD-në dhe LSI-në dhe të digjte mandatin e tij të deputetit të fituar nën siglën e PD-së në qarkun e Durrësit.